

CARITAS Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development



GOVERNMENT
PRINCIPALITY OF LIECHTENSTEIN



MARDI
Municipal Action for
Reintegration and Diaspora

Thirrje për Aplikim

Projektet investuese të diasporës

Autoriteti kontraktues: Caritas-i Zviceran në Kosovë

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:

30 nëntor 2022, ora 16:00

Tabela e Përmbajtes

1. GRANTET “Projektet Investuese të Diasporës”	3
1.1. Hyrje	3
1.2 Objektivat e Thirrjes për Propozime	4
1.3 Financimi	5
2. RREGULLAT E THIRRJES PËR PROPOZIME	6
2.1 Kualifikimi i aplikantëve	6
2.2 Sektorët ose temat	7
2.3 Veprimi / Lloji i Projektit	7
2.4 Kriteret e tjera të projektit	8
2.5 Pranueshmëria e aktiviteteve	9
2.6 Pranueshmëria e shpenzimeve	10
3. SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHET NDJEKUR	11
3.1 Metoda e aplikimit	11
3.2 Vlerësimi	12
3.2.1 Afati i fundit për aplikim	12
3.2.2 Informacione të tjera lidhur me aplikimin	12
3.2.3 Ankesat	12

1.1 Hyrje

Ekzistojnë tregues të shumtë që tregojnë potencialin e diasporës kosovare për të përmirësuar gjendjen e rëndë ekonomike në Kosovë. Remitancat, për shembull, përbëjnë hyrjet më të mëdha financiare në ekonominë kosovare, dhe ato përfaqësojnë mbi 12% të BPV-së së vendit. Sipas Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Kosova ofron një mjedis biznesi me potencial të lartë rritjeje. KIESA thekson se: *“një sistem i shkëlqyer tatimor, burimet e bollshme natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i biznesit dhe ligjet transparente për investimet e huaja”* e bëjnë Kosovën një vend interesant për investorët e huaj.¹ Përveç kësaj, Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, është pjesë e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), dhe ka nënshkruar Programin e Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave me Shtetet e Bashkuara, Japoninë dhe Norvegjinë dhe Marrëveshjen bilaterale të Tregtisë së Lirë me Turqinë. Duke përdorur Euron si valutë zyrtare, Kosova karakterizohet me një politikë monetare të qëndrueshme. Një tjetër element i rëndësishëm për investimet e huaja është kostoja e ulët operative, me kosto të ulët pune, tatimi në dividenda prej 0%, të ardhurat nga tatimi i korporatave janë të ulëta prej 10%, tatimi në të ardhurat personale është progresiv (nga 0% e deri 10% maksimalisht), dhe me një treg importi të liberalizuar. Pozita gjeografike e Kosovës është një tjetër avantazh ‘për të bërë biznes’.

Gjermania, Zvicra dhe Austria, shtete ku më së shumti është e përqendruar diaspora e Kosovës, renditen si burimet kryesore të investimeve të huaja direkte dhe destinacione kryesore të investimeve të huaja direkte (IHD) për Kosovën. Gjatë vitit 2020, në Kosovë ka pasur rreth USD 382 milionë IHD.² Shumë potenciale investimi janë vërejtur në sektorë të ndryshëm, siç janë: ndërtimtaria, industria e tekstit, turizmi,³ por edhe në sektorë të rinj e me zhvillim të shpejtë, siç është teknologjia e informacionit dhe komunikimit. Sektori i përpunimit të drurit përfshin prodhimin e kuzhinave, banjove, dyerve, mobileve të veshura me susta dhe të kombinuara të drurit, metalit dhe xhamit, si sektorë me potencial të lartë për tërheqjen e investime të huaja.⁴

Kjo Thirrje për Aplikim mbetet e përkushtuar për të mbështetur projektet edhe më të qëndrueshme të drejtuara nga gratë, për të fuqizuar gratë në të bërit biznes, si dhe për të rritur kapacitetet e tyre profesionale dhe menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjate të biznesit.

Kjo Thirrje synon të identifikojë dhe bashkëfinancojë projektet investuese më inovative dhe të qëndrueshme sipas një modaliteti të biznesit me partneritet - nga mbështetja e investorëve të diasporës për prodhim dhe shërbime, me ç’rast produktet e kërkuara prodhohen në vend, ndërsa mund të financohen shërbimet inovative dhe të qëndrueshme, siç janë: marketingu digjital, industritë kreative, riciklim i pajisjeve elektrike, shërbime gjeodezike, inxhinieria, shërbimet arkitekturore dhe shërbimet e programimit (softuerët).

¹ KIESA. Arsyet për të Investuar në Kosovë: <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1.15>

² Departamenti Amerikan i Shtetit, Deklaratat e Klimës së Investimeve në Kosovë, 2021: <https://www.state.gov/reports/2021-investment-climate-statements/kosovo/>

³ KIESA. Mundësitë e Investimeve në Kosovë: <https://www.rks-gov.net/EN/f150/investing-in-kosovo/investment-opportunities>

⁴ Departamenti Amerikan i Tregtisë: [Kosovo - Country Commercial Guide](#) 2021.

1.2 Objektivat e Thirrjes për Propozime

Qëllimi i Thirrjes për Propozime për Projektet Investuese të Diasporës është nxitja e partneriteteve biznesore midis bizneseve apo investitorëve nga diaspora dhe bizneseve vendore ose promovimi i themelimit të përfaqësive të kompanive të diasporës në nivel vendi. Për projektet biznesore inovative dhe të qëndrueshme, CACH do të ofrojë një grant të pakthyeshëm të përputhjes. Granti do të jepet në formë të bashkëfinancimit.

– Ky Program i Partneriteteve Biznesore mbështet projektet e dorëzuara nga ndërmarrjet në vlerë deri në 50% të projektit, të cilat njëkohësisht janë të përkushtuara për:

- Përfitimim zhvillimor të mirëqenies së përbashkët të Kosovës;
- Angazhimin e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit të tyre të origjinës dhe të komunave përkatëse;
- Përfitimim e ndërmarrësisë;

Agjenda zhvillimore e këtij Programi për Projekte Investuese të Diasporës duhet të jetë si në vijim:

- Vlera e shtuar zhvillimore, p.sh. përmirësimi i situatës së jetesës së popullatës vendore; forcimi i institucionet publike; aplikimi i teknologjisë së re dhe transferimi i njohurive;
- Mobilizimi i fondeve private shtesë dhe investimi në masat e rëndësishme të zhvillimit lokal;
- Efektet e optimizuara zhvillimore të marrëdhënieve private të biznesit dhe investimeve;
- Forcimi i konkurrencës, rrjedhimisht edhe mundësitë për ndërmarrjet tipike të vogla dhe të mesme të regjistruara në nivel lokal për të marrë pjesë në tregun global;
- Efektet pozitive mjedisore;
- Kontributet në përfshirjen sociale të grupeve minoritare;
- Fuqizimi i grave në kontekstin e biznesit lokal.

Agjenda e ndërmarrësisë së Programit të Partneritetit Biznesorë të Diasporës pasqyrohet në sa vijon:

- Suksesi i biznesit të kompanive evropiane është i garantuar në planin afatgjatë;
- Rreziku i investimit në Kosovë është minimizuar;
- Parametrat për angazhimin e bizneseve lokale janë përmirësuar.

1.3 Financimi

Në mënyrë që partneritetet biznesore të përfitojnë nga granti, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme të kualifikimit për të qenë të pranueshme:

- Së paku 50% e financimit duhet të sigurohet nga investitori i diasporës, së bashku me partnerin vendor të biznesit privat.
- CACH ofron grante deri në maksimalisht 50% të kostos së projektit.
- CACH ofron grante ndërmjet EUR 20.000 dhe 53.000
- Financimi nga palët e treta nga komunat vendore ose subjektet tjera vlerësohet dhe pranohet nën masën prej 50% të kontributit të vet aplikantit. Aksionet e diasporës duhet të jenë së paku 30% të buxhetit të përgjithshëm.

Shuma e përgjithshme e kësaj thirrje për propozime është 265,000.00 €. Do të konsiderohet shpërndarja e balancuar në rajone zhvillimore.

Aplikanti merr iniciativën për të angazhuar dhe zyrtarizuar partneritetin biznesorë, dhe për të dorëzuar projekt propozimin pranë CACH duke respektuar udhëzimet e prezantuara në këtë dokument. Është e detyrueshme që aplikacioni të përbëhet prej marrëveshjes së partneritetit midis biznesit vendor dhe të një biznesi nga diaspora, ose vërtetimi i themelimit të një përfaqësie lokale në vend. **Anekset e aplikacionit** mund të gjenden në vegëzën e mëposhtme:

<https://drive.google.com/drive/folders/1hV9UXD141wVFKQsCReXL3U-ocO166aaH?usp=sharing>

Sipas programit, CACH mund të mbështesë gjithashtu studimet e fizibilitetit, në rast se integrohen në propozim.

Bashkëfinancimi nga komunat inkurajohet, dhe duhet të dokumentohet me një shkresë të zotimit ose me ndonjë kontratë të bashkëfinancimit.

Në aplikacion mund të përmenden bizneset vendore, ndërkohë që të pranueshme janë edhe përfaqësitë lokale të kompanive të sapo regjistruara.

2.1 Kualifikimi i aplikantëve

Kush mund të aplikojë? Pranueshmëria

1. Investitori/pronari/menaxhmenti i kompanisë nga diaspora duhet të ketë shtetësinë kosovare ose aftësinë për të vërtetuar origjinën e tij/saj nga Kosova (si vendlindja e tij/saj ose e prindërve të tij/saj);
2. Aplikanti kryesor (edhe për konzorcium) duhet të jetë i regjistruar në Kosovë;
3. Një nga ndërmarrjet aplikuese duhet të ketë së paku 3 vite të funksionimit operativ; Partnerët e diasporës duhet të vërtetojnë gjithashtu së paku 3 vite përvojë në fushën e tyre përkatëse të aplikimeve;
4. Ndërmarrjet kosovare duhet të përmbushin kriteret që në momentin e aplikimit, të mos kenë kurrfarë detyrimi tatimor ndaj institucioneve të Kosovës;
5. Subjektet, menaxhmenti i të cilave në 5 vitet e fundit është dënuar me ndonjë vepër penale të paraparë në Kodin Penal të Kosovës ose në shtetin e tyre të regjistrimit, nuk mund të merren parasysh për këtë mundësi financimi.
6. Për konzorciumet: Nëse të paktën njëri partner plotëson kriteret e mësipërme, partneri shtesë ka të drejtë të marrë pjesë në projekt financiarisht ose me kontribute në vlerë tjetër monetare - si rregull - si një konzorcium formal. Për llogaritjen e shumës së financimit, kontributet e bëra nga këta partnerë konsiderohen edhe si kontributet e tyre (sipas pikës 1.3 të nenit).
7. Ndërmarrjet e diasporës duhet të kenë selitë në Zonën Ekonomike Evropiane (d.m.th. BE, Norvegji, Lihtenshtajn ose Islandë) ose Zvicër, SHBA ose Kanada, nëse ato kontribuojnë me burimet e tyre adekuatë (shih më poshtë);

Aplikantët të cilët nuk kualifikohen:

Aplikantët e mundshëm nuk mund të marrin pjesë në Thirrjen për Propozime ose të marrin grante nëse ndodhen në ndonjërin prej situatave të mëposhtme:

- Ato kanë falimentuar ose janë në mbyllje, janë nën administrim nga gjykata, kanë lidhur marrëveshje me kreditorët, kanë pezulluar aktivitetet e biznesit, i janë nënshtruar procedurave të lidhura me këto çështje, ose ndodhen në situata të ngjashme që rrjedhin nga procedura të përcaktuara nga legjislacioni ose rregulloret vendore;
- Ata, ose personat që kanë autorizimin e përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit mbi ta, janë dënuar për ndonjë vepër penale që lidhet me sjelljen e tyre profesionale me vendim të një autoriteti kompetent (d.m.th. kur nuk ka mundësi ankimi);
- Ata nuk janë në përputhje me detyrimet e tyre në lidhje me pagesën e kontributeve apo pagesën e tatimeve në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar;
- Ata, ose personat që kanë autorizimin e përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit mbi ta, u janë nënshtruar ndonjë vendimi të plotfuqishëm dhe të plotë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, pastrim parash ose ndonjë veprimtarie tjetër të paligjshme, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është i dëmshëm për interesat financiare të Kosovës.

2.2 Sektorët ose temat

Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve, si dhe në shërbimet tregtare kanë të drejtë të aplikojnë. Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet dhe të gjenerojnë eksporte ose që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit vendor.

Sektorët e mëposhtëm nuk mund të aplikojnë:

- Vetëm tregtim (me pakicë dhe shumicë),
- Ndërtimtari,
- Bujqësi (çfarëdo pajisje apo aktivitet që lidhet me fushën e bujqësisë financohet nga MBPZHR, përveç pajisjeve/makinerive për prodhimin dhe përpunimin e produkteve)
- Shëndetësi.

2.3 Veprimi / Lloji i Projektit

a. Ndikimi zhvillimor

Projekti duhet të gjenerojë përfitim të veçantë në aspektin zhvillimorë. Ai duhet të jetë në përputhje me qëllimet zhvillimore të Kosovës dhe të përmbushë kriteret e saj cilësore. Projekti duhet të kontribuojë në zhvillimin më të gjerë të komunave vendore në mënyrë ideale. Ai do të jetë në përputhje me agjendën zhvillimore rajonale të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal të Kosovës.

Kur ndërmarrjet e diasporës angazhohen në partneritete të drejtpërdrejta me biznesin vendor ose hapin një degë lokale, sektori privat vendor forcohet – veçanërisht pasi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u jepet qasje në tregjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo mund të përfshijë zhvillimin e mëtejshëm të zinxhirëve të furnizimit, masave të kualifikimit, transferimit të teknologjisë dhe njohurive, masave të përbashkëta të marketingut, proceseve të optimizuara të prodhimit ose aplikimit e standardeve të cilësisë, punës dhe sociale. Bizneset e diasporës mund të bashkëpunojnë si ndërmarrje të përbashkëta ose të lidhin kontrata menaxhimi ose marrëveshje të ekskluzivitetit.

Gjithashtu, Projektet Investuese të Diasporës mund të fokusohen në bashkëpunimin me akterët e mirëqenies sociale të vendit. Në këto raste, ndërmarrja investuese nga jashtë kontribuon në ofrimin e shërbimeve që për nga natyra janë realisht publike. Kjo mund të përfshijë programet e trajnimit dhe rifreskimit për profesionistët përmes institucioneve përgjithësisht të qasshme; transferimi i njohurive tek vendimmarrësit publikë ose shumëfishuesit; forcimi i komuniteteve ose krijimi i grupeve avokuese; masat vullnetare për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe mjedisit; kontributi në sistemin shëndetësor dhe në infrastrukturën lokale ose aplikimi i standardeve sociale.

b. Përfitimi i ndërmarrësisë

Ndërmarrjet duhet të demonstrojnë bindshëm efektivitetin e kostos së projekteve. Përfitimi ekonomik i projektit mund të jetë me avantazh të drejtpërdrejtë operacional ose me vlerë strategjike afatgjate. Rritja e konkurrueshmërisë ose perspektivat më të mira të biznesit për kompaninë - rritje e prodhimit, për shembull - qasje në tregjet e reja të furnizuesve dhe konsumatorit ose përfitimi i shtuar mund të jenë pika në këtë rast.

c. Ndarja e drejtë e përfitimit

Diaspora dhe partnerët vendor duhet të ndajnë përfitimet ose të ardhurat e krijuara nga projekti në proporcion të drejtë.

d. Qëndrueshmëria

Përfitimet e ndërmarrësisë dhe efektet zhvillimore duhet të jenë të qëndrueshme edhe pas përfundimit formal të projektit të mbështetur.

e. Shtimi

Projekti duhet të shtojë vlerë që nuk do të ishte krijuar pa ndihmën e projektit. Gjatë vlerësimit të projekteve, sigurohet që aktivitetet të cilat do të kishte kryer ndërmarrja e kualifikuar / efektet që do të kishin ndodhur gjithsesi nuk mbështeten. Gjithashtu, asistenca nuk u jepet aktiviteteve që kanë për qëllim të vetëm përmbushjen e obligimeve ligjore.

f. Neutraliteti

Konkurrenca e pandershme kundrejt kompanive që nuk marrin pjesë në projekt – siç janë pengesat për hyrje ose dalje, monopolet ose kartelet – duhet të shmanget kudo që është e mundur.

Propozimet për financim duhet të jenë teknikisht dhe financiarisht të pavarura. Veprimet duhet të kenë ndikim të prekshëm dhe të dukshëm në kompani dhe të rrisin punësimin, të rrisin kapacitetet prodhuese, të përmirësojnë ose optimizojnë jetëgjatësinë e zhvillimit dhe diversifikimit të produktit/shërbimit, kanalet e reja të shpërndarjes dhe shitjes në Kosovë apo në tregjet ndërkombëtare, zhvillimin e zinxhirit të vlerës dhe të ngjashme.

2.4 Kriteret e tjera të projektit

Financimi i projektit bazohet në aftësinë kreditore të aplikantit dhe në qëndrueshmërinë tregtare të planit të biznesit të lidhur me projektin. CACH verifikon gjendjen financiare të aplikantit dhe planin e biznesit nëse kërkohet.

a. Akterët tjerë / konzorciumet

Propozimi i projektit mund të përfshijë edhe institucionet vendore - komunat, agjencitë qeveritare, organizatat joqeveritare, institutet shkencore ose kompanitë e tjera përveç konzorciumeve. Ata mund të përfshihen si partnerë biznesi, dhe të cilët gjithashtu mund të ofrojnë kontribute jo-monetare (Kontributet jo-monetare duhet të jenë të matshme në vlerë monetare). Partnerët e tillë mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në, Rrjetet dhe Shoqatat e Biznesit të Diasporës, Odat Ekonomike Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare të Donatorëve.

b. Kontributet e konsiderueshme vetanake

Kontributet vetanake mund të marrin formën e parave të gatshme, pagesave në natyrë ose shërbimeve, siç janë ekspertizat teknike, njohuritë e të bërit biznes, teknologjitë ose kapitali, si dhe duhet të arrijnë të paktën 50% të kostos së projektit. Për konzorciumet, kontributet vetanake të pranueshme duhet të sigurohen nga aplikanti dhe partnerët e tjerë, me aplikantin kryesor që tejkalon 30% të kontributit.

c. Përkushtimi afatgjatë

Aplikanti duhet të angazhohet në një përkushtim afatgjatë në Kosovë, për shembull duke marrë rolin e investitorit. Duhet të sigurohet që përkushtimi ndaj biznesit të vazhdojë në një mënyrë ekonomikisht të

qëndrueshme përtej afatit të projektit. Prandaj, përjashtohen të gjitha projektet që përfshijnë eksportin ose importin jo të përsëritur të mallrave dhe shërbimeve, që nuk bazohen në ndonjë aktivitet tjetër vendor të ndërmarrjes.

d. Përgjegjësia për zbatimin e projektit

Bazuar në marrëveshjen e financimit, aplikanti merr përgjegjësinë për tërë projektin, edhe pse lejohet nën-kontraktimi për disa këste jo-thelbësore të projektit. Financimi CACH kontribuon në kostot e partneritetit të biznesit. Anëtarët e konzorciumit janë bashkëpërgjegjës për realizimin e kontratës së financimit.

e. Pajtueshmëria me dispozitat ligjore

Aplikanti merr përsipër të pajtohet me sistemin ligjor të Kosovës dhe të gjitha mekanizmat e aplikueshme ndërkombëtare të arbitrazhit, me Kodin e Sjelljes së CACH dhe me standardet etike të të bërit biznes.

Fokusi është në respektimin e standardeve ndërkombëtare të lidhura me të drejtat e njeriut, në veçanti me të drejtën për t'u organizuar dhe negociuar kolektivisht, paga e drejtë dhe kushtet e punës për të gjithë, ndalimi i punës së detyruar dhe punës së fëmijëve, si dhe diskriminimi në punë për shkaqe racore, të ngjyrës, gjinisë, religjionit, klasës shoqërore, opinionëve politike ose preferencave personale.

2.5 Pranueshmëria e aktiviteteve

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve në përputhje me objektivat e programit llogariten si shpenzime të pranueshme, dhe mund të financohen nga kjo Thirrje për Propozime:

- Investimet në asete të prekshme që lidhen ose me blerjen e pajisjeve, makinerive, linjave të prodhimit, softuerëve dhe të ngjashme ose/dhe me përmirësimin e proceseve dhe metodave të prodhimit, si dhe duke përfshirë asetet që mund të ndihmojnë kompanitë të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm;
- Trajnimet e specializuara lidhur me investimet e sipërpërmendura, p.sh. trajnimi për përdorimin e pajisjeve ose teknologjive të reja (ky komponent nuk mund të kalojë 10% të vlerës totale të projektit);
- Aktivitetet e marketingut (p.sh. pjesëmarrja në panairë, dhe/ose zhvillimi i faqeve të internetit, etj.) për të promovuar produkte dhe shërbime më të mira ose të reja (ky komponent nuk mund të kalojë më shumë se 10% të vlerës totale të projektit).

Llojet e mëposhtme të veprimeve NUK kualifikohen:

- Veprimet që lidhen vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca;
- Veprimet që lidhen vetëm ose kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- Programet e huave;
- Detyrat dhe veprimet operative që nuk kanë të bëjnë me zbatimin e projektit;
- Aktet që shkelin rregullat dhe rregulloret e pranura kombëtare dhe ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e punëtorëve në Kosovë.
- Projekti nuk duhet të mbështesë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, prodhimin ose përhapjen e armëve ose municioneve të tjera. Përjashtohen gjithashtu projektet që synojnë prodhimin ose tregtimin e mallrave të rrezikshme ose të substancave të dëmshme për mjedisin.

- Projekti duhet të jetë në përputhje me objektivat dhe prioritetet e Thirrjes për Propozime dhe të garantojë dukshmërinë e financimit nga CACH dhe MZHR.

2.6 Pranueshmëria e shpenzimeve

Vetëm “kostot e pranueshme” mund të merren parasysh për grantin. Kostot e pranueshme duhet të bazohen në shpenzimet aktuale dhe dokumentet mbështetëse.

Kostot e pranueshme janë:

- Kostot që lidhen me zbatimin e aktiviteteve të kualifikuara;
- Zërat e listuar në draftin e formularit të buxhetit të përgjithshëm;
- Zërat e nevojshëm për zbatimin e projektit;
- Zërat e identifikueshëm dhe të verifikueshëm, veçanërisht të regjistruar në regjistrat kontabël të Përfituesit;
- Zëra të arsyeshëm, të justifikuar brenda kërkesave të menaxhimit të qëndrueshëm financiar, veçanërisht në lidhje me ekonominë dhe eficiencën.

Kostot e mëposhtme nuk kualifikohen:

- Borxhet dhe tarifat e mbulimit të borxhit;
- Provizionet për humbjet dhe detyrimet potenciale të ardhshme;
- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të ardhura;
- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim ose program tjetër pune;
- Blerja e tokës, ndërtimi ose riparimi i objekteve/strukturave (duke përfshirë objektet e magazinimit ose objektet/strukturat e ngjashme);
- Humbjet e këmbimit valutor;
- Hua për palët e treta;
- Gjobat, gjobat financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Shpenzimet e amortizimit, të cilat normalisht duhet të jenë pjesë e mënyrës së ndarjes së fitimeve;
- Tarifat bankare, kostot e garancisë dhe tarifat e ngjashme;
- Kostot e artikujve ose pajisjeve të përdorura;
- Mëditjet/Pagat dhe përfitimet e stafit të projektit;
- Kostot e lëndës së parë;
- Shpenzime të tjera operative (qira, energji elektrike, ujë, etj.)
- Kostot e transportit; Mjetet e transportit;
- Inventari i zyrës (tavolina, karrige dhe kabinete, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë posaçërisht me aktivitetin).

Aplikacioni do të refuzohet nëse kostot e papërshtatshme tejkalojnë 20% të vlerës së projektit.

Duhet të paraqitet një buxhet real. Komisioni i Vlerësimit ka kompetencat për të trajtuar dhe hulumtuar çmimet e tregut në lidhje me çmimet e paraqitura në propozim.

Nëse Komisioni i Vlerësimit konstaton se çmimet e ofruara në ofertë dhe buxhet nuk janë reale, mund t'i korrigjojë ato si dhe të s'kualifikojë aplikacionin për shkak të mungesës së korrektësisë.

3.1 Metoda e aplikimit

Aplikantët ftohen të dorëzojnë aplikacionet e tyre përmes e-mail në: kosovo@caritas.ch, në CC lsekiraqa@caritas.ch.

Aplikimi duhet të bëhet nga personat që synojnë të nisin biznesin dhe jo nga persona të tjerë në emër të tyre;

Aplikimet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, angleze apo serbe.

Paketa e Aplikimit që duhet të plotësohet:

1. Formulari i aplikimit (Shtojca 1)
2. Formulari i buxhetit (Shtojca 2)
3. Deklarata e aplikantit (Shtojca 3), e cila merret edhe si deklaratë nën betim për vërtetësinë e dokumentacionit.

Aplikantët që mund të jenë përfitues potencialë të grantit gjatë aplikimit duhet të kenë dokumentet e mëposhtme dhe t'i dërgojnë ato me e-mail.

Dokumente të tjera shtesë (për aplikantin):

4. Certifikata e regjistrimit të biznesit me të gjitha dokumentet/informacionet mbështetëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të lëshohet nga ARBK-ja sipas numrit unik të identifikimit, përveç kësaj, edhe regjistrimi i biznesit të diasporës.
5. Certifikata e rezidencës tatimore e vlefshme në ditën e aplikimit; me të cilën vërtetohet se aplikanti nuk ka borxhe aktuale tatimore të papaguara apo obligime të tjera tatimore, ose që është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK-në (mund të lëshohet online nga ueb faqja e ATK-së);
6. Lista e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2021), e lëshuar nga ATK (mund të merret online nga ueb faqja e ATK-së).
7. Të ardhurat bruto të vërtetohen nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2021 të aplikantit kryesor; gjithashtu, pasqyra e të ardhurave/raporti vjetor i biznesit të diasporës.
8. Vërtetimi për të kaluarën kriminale të menaxherit të aplikantit kryesor;

Shënim: Dokumentet e listuara më sipër duhet të jenë qartësisht të dukshme në formatin PDF.

Aplikimet në prani fizike ose me shkrim nuk do të pranohen.

3.2 Vlerësimi

Vetëm aplikacionet e PLOTA do të kalojnë për vlerësim. Prandaj, është thelbësore që këto dokumente të përmbajnë TË GJITHA informacionet përkatëse rreth veprimit.

Vlerësimi i Aplikacioneve do të përfshijë një “verifikimin administrativ” për t'u siguruar që aplikantët kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Procesi i vlerësimit teknik do të marrë parasysh kriteret e lartpërmendura.

Në rastet kur ka mospërputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzion në përshkrimin e projektit dhe gabime në përdorimin e formateve të përcaktuara në Thirrjen për Propozime, projekti do të s'kualifikohet.

CACH nuk do të merr përsipër kurrfarë shpenzimi që lidhet me përgatitjen e një aplikacioni.

Vendimet për lejimin e bashkëfinancimit merren nga CACH, pas konsultimit dhe përzgjedhjes me një komision ekspertësh. Vendimet bazohen ekskluzivisht në këtë Udhëzues, në varësi të burimeve buxhetore në dispozicion. Nuk ka asnjë titull ligjor për pranimin e fondeve. Komisioni i ekspertëve përbëhet nga përfaqësuesit e CACH, MZHR, KIESA dhe Rrjetet/Asociacionet e Diasporës.

Përfituesit (pronarët e bizneseve që kanë marrë grante) nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2020, Programi për Rimëkëmbjen Ekonomike (PRE, MASA 8) 2020, Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2021 dhe Programi për Rimëkëmbjen Ekonomike (PRE, MASA 15) 2021 nuk kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje.

3.2.1 Afati i fundit për aplikim

Afati i fundit për aplikime është 30 nëntor 2022, ora 16:00, për t'u dorëzuar me e-mail në: kosovo@caritas.ch, në CC: lsekiraqa@caritas.ch. Pas këtij afati, sistemi mbyllet, aplikimet me prani fizike apo me postë nuk pranohen.

3.2.2 Informacione të tjera lidhur me aplikimin

CACH do të organizojë një sesion informues. Kërkesat me shkrim për sqarime mund të dërgohen në adresën: kosovo@caritas.ch, në CC lsekiraqa@caritas.ch, jo më vonë se deri më 10 nëntor 2022, ora 16:00.

3.2.3 Ankesat

Aplikantët mund t'i adresojnë ankesat e tyre me e-mail në: kosovo@caritas.ch, në CC lsekiraqa@caritas.ch, jo më vonë se deri më 10 dhjetor 2022, ora 16:00.